

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANILAS/DORËSHYRË DATUM PRINILJEN/DOSTAVLJEN DATE RECEIVED/SUBMITTED: 09-07-2025			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. faqesh Br. Stranica No. Pages
03	47	1200	5



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTERIA E ZHVILLIMIT RAJONAL - MINISTERSTVO ZA REGIONALNI RAZVOJ MINISTRY OF REGIONAL DEVELOPMENT ARHIVA / ARHIVA / ARCHIVE DALLËSE / DALLËSE / OUTGOING	
Nr./Br./No	602
Data / Datum / Date	08 / 07 / 2025
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINE	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Zhvillimit Rajonal
 Ministarstvo za Regionalni Razvoj
 Ministry of Regional Development

Prishtinë, datë: 08.07.2025

Për: Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme/ Zyra Kombëtare e Auditimit

Lënda: Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyres Kombëtare të Auditimit për v. 2024


E nderuar znj. Spanca

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) ka pranuar Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe duke u bazuar në raportin në fjalë, MZHR ka përgatitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyres Kombëtare të Auditimit për v. 2024.

Bashkangjitur kësaj shkrese, Ju lutem gjeni Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyres Kombëtare të Auditimit për v. 2024.

Jemi në dispozicionin Tuaj për ofrimin e sqarimeve shtesë!

Besim Kamberaj


 Sekretar i Përgjithshëm

Në kopje:

- Fikrim Damka, Minister i MZHR-së;



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR VITIN 2024

Korrik 2025

Nr.	Rekomandimet	Aktiviteti	Afati Kohor	Njësia përgjegjëse Sekretari i Përgjithshëm, DFSHP, ZHR	Arsyet për mos implementim
A1	Ministri duhet të sigurojë mekanizma dhe komunikim më efektiv në mes të palëve të përfshira në projektet me bashkëfinancim, në mënyrë që njoftimet të bëhen në kohë dhe bartja e pronësisë së pasurive të bëhet sipas rregullave në fuqi. Gjithashtu, të ndërmerren veprime për përditësimin dhe mbylljen e investimit në regjistrin e pasurive, në përputhje me dokumentacionin mbështetës.	DPKZHR ka kërkuar nga Zyrtari i pasurisë që të përcjell tek Komunitetet përfituese në baza periodike (çdo 3 muaj) kërkesën për progresin lidhur me pranimin teknik rrjedhimisht edhe regjistrimin e projektit në pasuri të komunës!	Qershor 2025	Sekretari i Përgjithshëm, DPKZHR	
B1	Ministri duhet të siguroj se janë përcaktuar politika monitoruese efektive në mënyrë që kriteret e vendosura për përfituesit të zbatohen për tu arritur qëllimi i synuar i përkrahjes së bizneseve.	Me rastin e hartimit të Udhëzuesit për aplikim PZHRB 2025, (Qershor 2025) Lista e punëtorëve e lëshuar nga ATK për vitin 2024 është kërkuar si dëshmi që biznesi kategorizohet tek bizneset Mikro apo të vogla, rrjedhimisht numri i punëtorëve nuk është kriter për poentim. Këti hapi i ka parapri edhe formulari për Monitorim me rastin e implementimit të Projekteve PZHRB 2023 miratuar me shkresën nr.833 datë 20/11/2023.	Qershor 2025	Sekretari i Përgjithshëm, DPKZHR	
A2	Ministri duhet të siguroj mekanizma më efikas të kontrollit për të bërë një monitorim më të rregullt dhe më të kujdesshëm të projekteve që financohen. Gjithashtu, është e domosdoshme që raportet e monitorimit në terren të hartohen në	Me vendimin për formimin e ekipit Monitorues nr.412 datë 21/05/2025, janë përcaktuar edhe obligimet e secilit zyrtar Monitorim për aplikimin e formatit të përcaktuar në manualin për	Maj 2025	Sekretari i Përgjithshëm, DPKZHR	

	<p>kohë të duhur dhe të përputhen me periudhat reale të zbatimit të projekteve të subvencionuara si dhe çdo aktivitet i raportuar të jetë i dokumentuar me dëshmi të qarta.</p>	<p>implementimin e Projekteve të OJQ-ve konform kushteve dhe kritereve që përshkruhen në Rregullorën e MF Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve dhe kritereve të përcaktuara me Kontratën e nënshkruar ndërmjet MZHR-së dhe OJQ-së.</p>			
C1	<p>Ministri duhet të siguroj kontrole efektive për të siguruar që të gjitha avanset/kartelat kreditore monitorohen dhe mbyllen brenda afateve të caktuara ligjore. Po ashtu, duhet të forcohet komunikimi dhe bashkëpunimi me Thesar dhe me akterët tjerë për të harmonizuar të dhënat dhe për të pasqyruar drejtë gjendjen e avanceve të hapura.</p>	<p>Janë ndërmarr te gjitha hapat për barazim si dhe janë derguar emaila në thesar për barazimin e gjendjes me banken, jemi në pritje te pergjigjes nga thesari.</p>	<p>Dhjetor 2025</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm, DBF</p>	
A3	<p>Ministri duhet të ndërmerr masa për gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme për funksionalizimin e njësisë së auditimit të brendshëm. Në rast të dështimit të procedurave të rregullta të rekrutimit, të shqyrtohen mundësi alternative ose për transferim të përkohshëm të auditorit të brendshëm nga organizatat tjera buxhetore, për shkak të rëndësisë që ka ky funksion për ministrinë.</p>	<p>Ministria e Zhvillimit Rajonal, ka marrë veprimet për ta plotësuar këtë pozitë, kemi shpallur dy konkurse për rekrutimin e pozitës se lir, mirëpo konkursi i par ka dështuar ndërsa konkursi i dyte ende është në proces të rekrutimit. Andaj në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive tona institucionale si MZHR, ju me datë 20.06.2025 ju kemi drejtu Njësisë Qendrore Harmonizuese me kërkesë që të na sigurojnë një auditor për realizimin e auditimit të brendshëm për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal për periudhën deri në plotësimin e pozitës së Udhëheqësit të</p>	<p>Dhjetor 2025</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm, NJMBNJ,</p>	

		Njesisë së Auditimit të Brendshëm të MZHR-së.			
--	--	--	--	--	--

